



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit- Ured Ministra -Office of the Minister

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHENDETESISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. i faqeve Stranica No. pages	-1-
Nr. Prot. Prot. No.	05-4289
Data: Datum:	07/06/2024
Prishtinë / a	

Nr: 116/VI/2024

Datë: 07.06.2024

Ministrisë i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019),nenit 11 paragrafi 1.5 i Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neni 5 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale, nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe pas propozimit të Komisionit për çmimet e produkteve medicinale me shkresën Nr.05-4282, datë 06.06.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Anullohet vendimi nr.prot: 05-3676 i datës 15.05.2024.
- II. Obligohet Komisioni për çmimet e produkteve medicinale që brenda një afati sa më të shkurtër kohor të bëjë propozimin e listës sipas gjetjeve të Komisionit për Ankesa.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni për çmimet e produkteve medicinale me datë 15.05.2024 ka propozuar Listën zyrtare preliminare të çmimeve të produkteve medicinale në Republikën e Kosovës. Lidhur me këtë dhe në zbatim të Ligjit Nr.08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale, Ministri i Shëndetësisë ka nxjerrur vendimin nr.prot: 05-3676 i datës 15.05.2024 me të cilin ka miratuar propozimin e Komisionit. Kundër vendimit të ministrit dhe sipas rregullave të procedurës së përgjithshme administrative, palët aplikuese kanë parashtuar ankesa me pretendimet e tyre disa prej të cilave janë të konfirmuara nga Komisioni i Ankesave në Ministrinë e Shëndetësisë. Andaj, duke marrë për bazë që lista e propozuar nga Komisioni dhe e miratuar nga Ministri nuk ka qenë përfundimtare si dhe në zbatim të Ligjit Nr.08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale dhe dispozitave të nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dr. Arben Viti

Ministër i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- Zëvendësministrave të MSH-së;
- Sekretarit i Përgjithshëm;
- Znj. Virtyte Krasniqi, Kryesuese e Komisionit;
- Komisionit të ankesave;
- Departamentit ligjor;
- Arkivit të MSH-së.

